Влада на Република Северна Македонија

Në bazë të nenit 19 paragrafi (7) të Ligjit doganor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 39/05, 4/08, 35/10, 48/10, 158/10, 44/11, 53/ 11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16, 144/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më ----------------të vitit 2023, miratoi

# VENDIM
# PËR HEQJEN E TAKSËS SË IMPORTIT – NORMË DOGANORE PËR IMPORT TË QUMËSHTIT DHE AJKËS

## Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet masa për heqjen e taksës së importit – normë doganore gjatë importit të qumështit dhe ajkës edhe atë:

| Shenja tarifore | Përshkrim |
|---|---|
| 0401<br><br>0401 50<br><br>0401 50 39 00 | Qumësht dhe ajkë, të pakoncentruara dhe pa sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim:<br>- Me përmbajtje të yndyrave, që tejkalon 10% sipas masës:<br>- - Që tejkalon 21% por nuk tejkalon 45%:<br>- - - Tjetër |
| 0402<br><br>0402 91<br><br>0402 91 59 00 | Qumësht dhe ajkë, të koncentruara dhe me sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim:<br><br>- Tjetër:<br>- - Pa sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim:<br>- - - Me përmbajtje të yndyrave, sipas masës, që tejkalon 10% por nuk tejkalon 45%:<br>- - - - Tjetër |

## Neni 2

Mallrat nga neni 1 i këtij vendimi, do të importohen deri më 31 dhjetor të vitit 2023.

Влада на Република Северна Македонија

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

| | | |
|---|---|---|
| Nr. ___________<br>____shtator të vitit 2023<br>Shkup | | Kryetar u Qeverisë<br>së Republikës së Maqedonisë së Veriut,<br>dr. Dimitar Kovaçevski, n.p. |

Влада на Република Северна Македонија

# A r s y e t i m

Me këtë vendim propozohet heqje e përkohshme e normës doganore prej 20% për shenjën tarifore 0401 50 39 00 Qumësht dhe ajkë, të pakoncentruara dhe pa sheqer të shtuar ose materie të tjera ëmbëlsuese me përmbajtje yndyre në masë që tejkalon 21% por jo më shumë se 45%. Norma të tjera dhe doganore prej 15% për shenjën tarifore 0402 91 59 00 Qumësht dhe ajk, e pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar me përmbajtje yndyre në masë që tejkalon 10%, por jo më shumë se 45%, të tjera. Këto norma doganore zbatohen gjatë importit nga vende të tjera.

Importi i këtyre shenjave tarifore nga vendet e CEFTA-s është pa doganë, ndërsa importi i shenjës tarifore 0401 50 39 00 nga shtetet anëtare të BE-së bëhet me normë doganore 15%, ndërsa importi i shenjës tarifore 0402 91. 59 00 bëhet pa doganë. Implikimet fiskale për vitin 2022 arrijnë 37.337,1 euro ose 2.296.231 denarë, ndërsa për periudhën janar-korrik të vitit 2023, 29.616 euro ose 1.821.356 denarë.

Propozim-vendimi pë rheqjen e taksës së importit – normës doganore për importin e qumështit dhe ajkës propozohet me qëllim të uljes së çmimeve të këtyre produkteve.

**Importi i qumështit dhe ajkës**

**viti 2023 (1-7)**

| Vendi | Shenja tarifore | Përshkrimi | Importi kg | Importi EUR | norma doganore % | vlera doganore (në euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Serbia | 0401503900 | Qumësht dhe ajkë, të pakoncentruar pa sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim me përmbajtje të yndyrave sipas masës, që tejkalon 21%, por nuk tejkalon 45%, Tjetër | 200 | 740 | 0 | 0 |
| Gjermania | 0402915900 | Qumësht dhe ajkë, të koncentruar ose me sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim me përmbajtje të yndyrave sipas masës, që tejkalon 10%, por nuk tejkalon 45%, Tjetër | 97.710 | 197.437 | 15 | 29616 |
| | | **Gjithsej** | **97.910** | **198.177** | **15** | **29.616** |

**Importi i qumështit dhe ajkës**

**viti 2022**

| Vendi | Shenja tarifore | Përshkrimi | Importi kg | Importi EUR | norma doganore % | vlera doganore (në euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Serbia | 401503900 | Qumësht dhe ajkë, të pakoncentruar pa sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim me përmbajtje të yndyrave sipas masës, që tejkalon 21%, por nuk tejkalon 45%, Tjetër | 480 | 1.777 | 0 | 0 |
| Serbia | 402915900 | Qumësht dhe ajkë, të koncentruar ose me sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim me përmbajtje të yndyrave sipas masës, që tejkalon 10%, por nuk tejkalon 45%, Tjetër: | 1.460 | 3.987 | 0 | 0 |
| Turqia | 402915900 | Qumësht dhe ajkë, të koncentruar ose me sheqer të shtuar ose materie të tjera për ëmbëlsim me përmbajtje të yndyrave sipas masës, që tejkalon 10%, por nuk tejkalon 45%, Tjetër: | 229.730 | 248.914 | 15 | 37337 |
| | | **GJITHSEJ** | **231670** | **254.678** | **15** | **37337,1** |